

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË  
SEKTORI PËR ÇËSHTJE FINANCIARE  
- NJËSIA AKTUARE -

# RAPORTI AKTUAR

(version i shkurtër)

.....  
PËR SISTEMIN PENSIONAL NË REPUBLIKËN E  
MAQEDONISË ME PROJEKSIONE AKTUARE

*Shkup, Dhjetor 2013*

# **Raport për sistemin pensional në Republikën e Maqedonisë me projeksione aktuale – version i shkurtër**

## **Hyrje**

Ky është një version i shkurtër i Raportit vjetor me projeksione aktuale i Njesisë aktuale të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë për vitin 2012. Njësia me ndihmën e modelit aktuar, siguron projeksione afatshkurtë dhe afatgjatë të të hyrave dhe të dalave të Fondit në bazë të supozimeve ekonomike dhe demografike të trendeve të zhvilluara dhe varijacionet e tyre varësisht prej supozimeve të ndryshme për politikën e pensioneve. Projektionet aktuale shfrytëzohen për përkrahjen e reformave pensionale të cilat zbatohen nga ana e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale si dhe Fondit të SPIM-së, përforcimin e kapacitetit për zhvillimin e politikës së pensioneve dhe për punën aktuale të Fondit të SPIM-së.

Raporti përmban 5 kapituj dhe fillon me strukturën e sistemit pensional në Republikën e Maqedonisë dhe reformat në periudhën prej vitit 1993-1997, mandej vazhdon me përshkrimin e shkurtër të sistemit pensional maqedonas, gjendjen aktuale financiare të Fondit si dhe projektionet për gjendjen e ardhshme financiare të Fondit. Pjesa më qenësore e raportit është kreu i katërt i cili i përmban projektionet aktuale për gjendjet e ardhshme në sistemin pensional. Analizat e shpenzimeve tranzitive janë të rëndësishme së veçantë të këtij kreu. Kreu i fundit jep përshkrim dhe informacion të shkurtër për aktivitetet e Njesisë aktuale në vitet e fundit.

## **Struktura e sistemit pensional të Maqedonisë**

Strukturën e sistemit pensional maqedonas do ta kishim definuar në këtë mënyrë:

\* *sigurim i detyrueshëm pensional dhe invalidor në bazë të solidarizimit të gjeneratave (shtylla e parë)* i organizuar në bazë të principit financiar aktual (pay-as-you-go) me pensione të definuara, që e paraqet sistemin e deritanishëm me racionalizim të kryer. Ky lloj i sigurimit do të siguron realizimin e të drejtës së sigurimit pensional dhe invalidor në rast të pleqërisë, invaliditetit dhe vdekjes, që don të thotë se do të paguhet një pjesë nga pensioni i pleqërisë, pensionit invalidor dhe pensionit familjar si dhe vlera më e ulët e pensionit.



Ñ *sigurimi i detyrueshëm pensional me financim kapital (shtylla e dytë)*. Me këtë sigurim do të sigurohet realizimi i të drejtës së sigurimit pensional në rast të pleqërisë, përkatësisht do të paguhet pjesa e mbetur nga pensioni i pleqërisë. Kjo mënyrë e sigurimit është në principin e mbledhjes së mjeteve nëpërmjet pagesës së kontributeve në llogari individuale (personale), të cilat mjete mandej investohen dhe së bashku me përfitimin akumulohen në llogaritë. Pas

pensionimit do të merren mjetet e akumuluar nëpërmjet anuitetit (arkëtim vjetor) ose tërheqjeve të programuara.

Ë *sigurim pensional vullnetar me financim kapital ( shtylla e tretë )* në të cilën mund të përfshihen të gjithë personat të cilët dëshirojnë të sigurojnë një vëllim më të lartë të sigurimit material nga sigurimi i detyrueshëm si dhe të gjithë qytetarët të cilët nuk janë përfshirë në sigurimin e detyrueshëm.

### ***Përshkrim i shkurtër i sistemit pensional të Maqedonisë***

Të drejtat që rrjedhin nga sigurimi pensional dhe invalidor janë:

- *E drejta e pensionit të pleqërisë* ( I siguruari arrin të drejtën e pensionit të pleqërisë atëherë kur do të arrijë moshën 64 vjeçe, për burrat dhe 62 vjeç për gratë, më së paku me 15 vjet stazh pensional)
- *E drejta e pensionit invalidor* ( I siguruari të i cili do të shkaktohet paaftësi e përgjithshme për punë si dhe i siguruari me aftësi të ngelur për punë i cili për shkak arritjes të një moshe të caktuar nuk mund që me rehabilitim profesional të aftësohet për kryerjen e ndonjë pune tjetër përkatëse, arrin të drejtën e pensionit invalidor në bazë të dy kushteve të dhëna).
- *E drejta e pensionit familjar* ( Pension familjar mund të realizojnë anëtarët e familjes të të siguarit të ndjerë: bashkëshorti/ja, fëmijët dhe prindërit që i ka ushqyer i siguruari nën kushtet e përcaktuara me ligj).
- *Rehabilitim profesional*
- *E drejta e kompensimit në të holla për dëmtim fizik*
- *E drejta e vlerës më të ulët të pensionit*

### ***Gjendja financiare aktuale e Fondit të SPIM-së (viti 2012)***

Puna financiare e Fondit të SPIM-së gjatë vitit 2012 zhvillohej në mbështetje me politikën e paraparë makroekonomike të Republikës së Maqedonisë për vitin 2012 dhe mjetet e planifikuara me Buxhetin e Fondit.

Fondi gjatë këtij viti realizoi gjithsej të hyra në shumë prej 46.370,63 milion denarë dhe gjithsej të dala në shumë prej 46.226,76 milion denarë, përkatësisht tepriçë të të hyrave mbi të dalat në shumë prej 143,87 milion denarë. Kjo tepriçë e mjeteve është transferuar në vitin 2013.

Reduktimi i shkallës së kontributit për sigurim pensional dhe invalidor në 18% nga 1 janari i vitit 2011 si dhe kriza ekonomike kishin ndikim në punën financiare të Fondit. Në punën financiare të Fondit ndikonte edhe mosrealizimi i plotë i indikatorëve të paraparë makroekonomik të cilët drejtpërdrejtë ndikojnë në realizimin e të hyrave nga kontributet. Për shkak gjendjes së këtyllë financiare, Fondi në vitin 2012 për pagesën e pensioneve në kohë të duhur, në afatet e caktuara, gjatë pagesës së pensioneve shfrytëzoi hua nga Buxheti i Vendit.



Përcaktim themelor në realizimin e të dalave të Fondit ishte kujdesi për shpenzimin racional dhe të duhur të mjeteve në mbështetje me obligimet që rrjedhin nga dispozitat ligjore. Në anën e të dalave është vërejtur rritje e të dalave për 4,3%

në raport me të realizuarat në vitin 2011, si rezultat i harmonizimit të pensioneve për 1,71% dhe rritjes së shfrytëzuesve të pensionit prej 1,2%.

Harmonizimi i pensioneve në vitin 2012 është kryer në mbështetje me dispozitat aktuale edhe atë prej 1 janarit të vitit 2012 arrinte 0,31%, ndërsa prej 1 korrikut të vitit 2012 arrinte 1,4%, përkatësisht gjithsej harmonizimi në vitin 2012 arrinte 1,71%.

### ***Të dhëna statistikore më të rëndësishme nga zbatimi i sigurimit pensional dhe invalidor me gjendje në vitin 2012***

Në vitin 2012 Fondi realizoi gjithsej të hyra në shumë prej 46.370,63 milion denarë dhe gjithsej të dala në shumë prej 46.226,76 milion denarë, përkatësisht realizoi tepriçë të të hyrave mbi të dalat në shumë prej 143,87milion denarë. Me mjetet e transferuara monetare nga viti 2011 në shumë prej 398,23 milion denarë, saldoja e mjeteve monetare më 31.12.2012 arrin 542,10 milion denarë. Struktura e të hyrave dhe të dalave është paraqitur në dy grafikonet vijuese:



Gjithsej numri i shfrytëzuesve të pensionit në fund të vitit 2012 arrinte 282.334 nga të cilët 43.670 shfrytëzues të pensionit invalidor me pension mesatar prej 9.934 denarë; 76.593 shfrytëzues të pensionit familjar me pension mesatar prej 8.634 denarë dhe 162.071 shfrytëzues të pensionit të pleqërisë me pension mesatar prej 12.437 denarë. Përveç këtyre shfrytëzuesve ka edhe 1.124 shfrytëzues të pensioneve minimale bujqësore dhe 1.953 shfrytëzues të pensioneve ushtarake, me çka gjithsej numri i shfrytëzuesve të pensionit arrin numrin prej 285.411 shfrytëzues.

Gjithsej numri i shfrytëzuesve të pensionit (së bashku me pensionet minimale bujqësore dhe pensionet ushtarake) në vitin 2012 në krahasim me numrin e shfrytëzuesve të pensionit në vitin 2011 është më i madh për 4.520 shfrytëzues apo për 1.6%.

Krahasimi i pensionit mesatar (i paguar në dhjetor të vitit 2012 në shumë prej 11.016 denarë) dhe gjithsej paga mesatare në Vend për periudhën e njëjtë prej 21.469 denarë arrin 51,3%.

Harmonizimi i pensioneve në vitin 2012 është kryer në mbështetje me dispozitat aktuale edhe atë prej 1 janarit të vitit 2012 arrinte 0,31%, ndërsa prej 1 korrikut të vitit 2012 arrinte 1,4%, përkatësisht gjithsej harmonizimi në vitin 2012 arrinte 1,71%.

### ***Projeksione aktuale për gjendjen e ardhshme financiare të sistemit pensional***

Njëri nga instrumentet e planifikimit të politikës së pensioneve janë modelet aktuale me të cilët bëhen projeksione për gjendjet në sistemin pensional në bazë të parametrave të supozuara demografike dhe ekonomike dhe supozimeve të ndryshme të politikës së pensioneve. Periudha prej 80 viteve shfrytëzohet për vlerësimin e gjendjes financiare të Fondit si dhe për parametrat tjerë, të rëndësishëm për fushën pensionale.

Të ardhurat dhe të dalat e ardhshme të Fondit varen nga shumë faktorë demografik dhe ekonomik, siç janë mortaliteti, fertiliteti, invaliditeti, fuqia punëtore, papunësia, rrogat mesatare, inflacioni etj.

Me qëllim të projektimit të këtyre parametrave Njësia aktuale në bazë të të dhënave të Fondit të SPIM-së, Ministrisë së Financave dhe Entit Shtetëror për Statistikë si dhe në bazë të analizave të deritanishme dhe hetimeve përgatit supozime. Projektionet që janë rezultat i supozimeve tregojnë se çfarë do të ndodhte në të ardhmen po qe se realizohen supozimet e dhëna ekonomike dhe demografike.



Për shkak periudhës së gjatë të projektit (80 vjet) bëhen tre grupe të supozimeve: optimiste, bazike dhe pesimiste. Terminet për supozime optimiste, bazike dhe pesimiste shikohen nga aspekti i Fondit, përkatësisht optimiste don të thotë shpenzime të ulëta për Fondin, përderisa pesimiste don të thotë shpenzime të larta për Fondin. Në supozimet bazike merren të dhënat nga indikatorët makroekonomik nga Ministria e Financave përderisa supozimet optimiste dhe pesimiste krijohen në bazë të supozimeve bazike. Rezultatet optimiste dhe pesimiste i përfaqësojnë kufinj të lëvizjeve të ardhshme të parametrave të sistemit pensional në Republikën e Maqedonisë.

Me modelin aktuar projektohen madhësia dhe struktura e popullsisë, numri i të sigurve dhe pensionistëve, lëvizja e kontributeve nga pagat dhe pensionet si dhe madhësi tjera relevante që janë të rëndësishme së madhe për punën e Fondit. Në modelin aktuar për shkak të ndjekjes më të lehtë të rezultateve, të njëjtat janë dhënë në krahasim me BPV (bruto prodhimi vendor) për shkak ndikimit të inflacionit dhe vështirësive për shkak të krahasimit nominal të vlerës së denarit gjatë periudhave të ndryshme.

Pika fillestare për simulimin e skenarit me modelin janë të dhënat të cilat e përshkruajnë gjendjen e tanishme të sistemit pensional (pensionistë sipas moshës,


gjinisë dhe llojit të pensionit, pensioni mesatar, të siguruarit sipas moshës dhe gjinisë e të tjerë, si dhe të dhënat themelore makroekonomike dhe demografike – shkalla e fertilitetit dhe mortalitetit).

### - Parashikime demografike

Supozime themelore demografike të rëndësishme për sistemin pensional janë supozimet për shkallën e fertilitetit dhe jetëgjatësia e pritur.

Shkalla e fertilitetit në të trija skenaret lëviz nga 1,50 deri më 2,10 në afat të gjatë (periudhë projektuese prej 70 viteve), përderisa shkalla e domosdoshme e fertilitetit për popullatë stabile në afat më të gjatë duhet të arrijë 2,1.

Pasqyrim i jetëgjatësisë së pritur gjatë lindjes dhe gjatë pensionimit në shtatëdhjetë vitet e ardhëshme është paraqitur në grafikonat vijues:



### - Supozimet ekonomike

Supozime themelore ekonomike të cilat shfrytëzohen në këtë model janë supozimet për rritjen reale të bruto prodhimit nacional, rritja reale e pagave, shkalla e papunësisë, inflacioni etj. Shkalla e papunësisë në mënyrë direkte e përcakton numrin e të punësuarve, përkatësisht personat e siguruar të cilët paguajnë kontribut. Parametrat ekonomik kanë ndikim edhe në pjesën e të dalave në Fond. Lëvizja e pagave dhe shpenzimeve të jetës e përcaktojnë harmonizimin e pensioneve, përkatësisht ndikojnë në madhësinë e pensioneve dhe me atë edhe në të dalat e Fondit.

Shkalla e papunësië reduktohet nga të tanishmet 31,0% në 18,0% në vitin 2013 në skenarin bazik, 16% në skenarin optimist edhe në 20% në skenarin pesimist dhe në këto nivele mbahet deri në fund të periudhës projektuese, përkatësisht deri në vitin 2080. Rritja reale e pagave ndryshon në varësi të skenarit. Në skenarin optimist rritja e pagave prej vitit 2030 e tutje arrijnë 3,50%, në skenarin bazik prej vitit 2030 e tutje arrijnë 3,00%, ndërsa prej vitit 2030 e tutje në skenarin pesimist të arrijnë 2,50%. Përqindja për rritjen e shpenzimeve të jetës prej të tanishmeve 3,5% në skenarin bazik parashikohet që në vitin 2040 të reduktohet në 2,0%, në skenarin pesimist në 2,5% dhe në skenarin optimist në 1,5%.



## - **Ndryshime në politikën e pensioneve**

Mosha e pensionimit është rritur gradualisht dhe në vitin 2001 arriti në 64 vjet (për burra) dhe 62 vjet (për gra), ndërsa mosha mesatare e pensionimit (për shkak të disa ndryshimeve në Ligjin me të cilin është mundësuar pensionimi i parakohshëm i disa të siguruarve, për shkak të pensioneve invalidore dhe pensioneve familjare dhe për shkak të të siguruarve me stazh të sigurimit i cili llogaritet me kohëzgjatje të shtuar) arrin 62 vjet për burra dhe 61 vjet për gra. Shkalla e zëvendësimit duke filluar nga viti 2013 fillon të reduktohet gradualisht në periudhë prej 40 vjet. Harmonizimi i pensioneve bëhet me 50% nga rritja e shpenzimeve të jetës dhe 50% nga rritja e pagave.

Në këtë model pagesa e kontributeve në shtyllën e dytë hyri me fillimin e janarit të vitit 2006 si dhe filloi në mënyrë reale.

Gjithsej kontributi i cili paguhet në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor nga 1 janari i vitit 2010 arrin:

- 18% nga bruto paga për të siguruarit të cilët nuk do të përfshihen në shtyllën e dytë;
- 11,7% nga bruto paga për shtyllën e parë për të siguruarit të cilët do të përfshihen në shtyllën e dytë;
- 6,3% nga bruto paga për shtyllën e dytë për të siguruarit të cilët do të përfshihen në shtyllën e dytë

Kjo shkallë e kontributeve, e njëjtë deri në vitin 2013, në vitin 2014 reduktohet në 17,6% dhe në vitin 2015 në 17,5%. Shkalla e kontributeve për shtyllën e dytë me ndryshimet e fundit të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor (Gazeta zyrtare nr. 98/2012) është fiksuar në 6% në vend të ndarjes së tanishme e cila ishte e rregulluar me 65% nga gjithsej kontributi është për shtyllën e parë, ndërsa 35% për shtyllën e dytë. Dallimi ndërmjet gjithsej shkallës së kontributeve dhe 6% për shtyllën e dytë mbetet në shtyllën e parë.

Në lidhje me shkallën e zëvendësimit dhe për shkak ndryshimeve në politikën pensionale, në mbështetje të ligjit parashikohet parashikohet 30% shkallë e zëvendësimit për vitet e plota të stazhit (35 vjet – grua, 40 vjet – burrë) nga shtylla e parë për të siguruarit të cilët do të përfshihen në sistemin e ri dhe shkallën e zëvendësimit të pritur nga shtylla e dytë e cila në masë më të madhe varet kontributi i investimeve në fondet pensionale private.

## - **Projeksione për popullatën**

Indikatorë për plakjen e popullsisë është krahasimi i popullatës së vjetër (në moshë mbi 65 vjet ) me popullatën e aftë për punë ( në moshë prej 18 deri më 64 vjet). Në dy grafikonat vijues është paraqitur krahasimi i popullatës së vjetër me popullatën e aftë për punë dhe lëvizja e këtij krahasimi në të tria skenaret.



Krahasimi i këtyre dy grupeve të popullatës rritet nga të tanishmet 17,68% në 53,03% në vitin 2060 dhe reduktohet deri në 47,34% në vitin 2080. Kjo do të thotë se në të ardhmen rreth një e treta e popullatës mbi 18 vjeç do të jetë popullatë e vjetër.

Sipas skenarit optimist ky krahasim e arrin maksimumin prej 47,9% në vitin 2060 që në vitin 2080 të reduktohet në 41,07%. Në skenarin pesimist krahasimi lëviz nga maksimalet 56,85% në vitin 2070 deri më 52,96% në vitin 2080. Mund të përfundohet se sipas të tre skenareve ekziston mplakje e popullatës në afat më të gjatë.

**- Projektione në sistemin pensional**



Lëvizja e ardhshme e numrit të të sigurve dhe pensionistëve sipas skenarit bazik si dhe krahasimi i tyre është paraqitur në këtë grafik.


Nga trafikoni mund të vërehet se në periudhën fillestare të projeksioneve deri në vitin 2030 numri i të sigurve rritet, ndërsa pas vitit 2030 numri i të sigurve fillon të reduktohet për shkak të lëvizjeve demografike dhe stabilizimit të rritjes ekonomike.

Numri i pensionistëve në mënyrë të vazhdueshme rritet në 50 vitet e ardhshme, pastaj reduktohet. Krahasimi mes të sigurve dhe pensionistëve nga të tanishmit 1,74% të sigurve në një pensionist në afat më të gjatë reduktohet në 1,03 të sigurve në 1 pensionist. Ky trend i krahasimit do të thotë se gjithnjë e më pak të sigurve do të paguajnë për një numër më të madh të pensionistëve.

Për krahasim këto rezultate janë paraqitur në trafikoni vijues së bashku me rezultatet nga skenari optimist dhe pesimist.




**Krahasimi të siguruarit - pensionistët në të tre skenaret**



**- Shpenzimet për pensione**

**Shpenzimet për pensione në raport të BPV**



Nga grafikoni mund të vërehet një zvogëlim gradual i shpenzimeve për pensione në të tre skenaret.


Kjo ka të bëjë me dy faktorë: reduktimi i obligimeve të Fondit për shkak të reformave parametrike, përkatësisht reduktimi gradual i shkallës së zëvendësuar prej 80% në 72% për të siguruarit wë do të mbeten në shtyllën e

parë dhe vëllimi i reduktuar i pensioneve për të siguruarit të cilët do të kalojnë në shtyllën e dytë sepse shkalla zëvendësuese e shtyllës së parë arrin vetëm 30% me atë se këta të siguruar pjesën tjetër të pensionit do ta pranojnë nga shtylla e dytë. Në skenarin bazik shpenzimet për pensione reduktohen prej 8,3% nga BPV-ja në vitin 2013 në 6,66% nga BPV-ja në fund të periudhës së projeksionit.

**- Ndikimi ndaj të hyrave dhe të dalave të FSPIM-së**


Se si të gjithë këto faktorë ndikojnë në punën financiare të Fondit deri në vitin 2080 mund të shihet në grafikonin e mëposhtëm. Në grafikon janë paraqitur të hyrat dhe të dalat e Fondit në krahasim me bruto prodhimin vendor si dhe deficitin.

### Të hyrat dhe të dalat e Fondit të SPIM-së



Projeksionet e sistemit pensional të reformuar tregojnë se Fondi do të punojë me deficit i cili do të reduktohet në afat të gjatë. Deficiti i Fondit të SPIM-së përbëhet prej këtyre komponentëve: deficit për shkak të defluktimit të kontributeve në shtyllën e dytë (shpenzimet transitive), deficit strukturor i Fondit i cili paraqitet për shkak jo baraspeshës të të hyrave aktuale me të dalat

### Analizë e shpenzimeve transitive



Në grafikon janë paraqitur të tre skenaret për transferin e nevojshëm nga Buxheti për financimin e shpenzimeve transitive për shkak vendosjes të shtyllës së dytë. Shpenzimet transitive janë të karakterit të përkohshëm dhe me kalimin e kohës do të humbin. Këto fillojnë në vitin e parë të reformës

dhe gradualisht zmadhohen ndërsa në vitin 2020 pritet se do të arrijnë në nivel prej 1,34% nga BPV. Maksimumin e tyre prej 1,65% nga BPV e arrijnë në vitin 2030 në të cilën periudhë do të rritet pjesëmarrja e fuqisë punuese në shtyllën e dytë dhe me këtëedhe deflukti i kontributeve nga shtylla e parë do të jetë i rëndësishëm.

Shpenzimet transitive humbin në vitin 2045 atëherë kur do të ndriçojë shtylla e dytë me çka barra e financimit të pensioneve kryesisht bartet në shtyllën e dytë ndërsa në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në reduktimin e shpenzimeve për pensione në shtyllën e parë.

Shpenzimet transitive janë të administruara më tepër nga demografia se sa nga ekonomia. Në skenarin optimist kanë vlera më të larta se sa në atë pesimist nga arsye të thjeshta që parametrat ekonomik janë më të mirë në atë skenar, apo me fjalë të tjera BPV dhe rritja e pagave gjithashtu është më e lartë që do të thotë se kapaciteti për financimin e shpenzimeve është më i lartë. Në skenarin pesimist gjendja është e kundërt.

### *Informacione për punën e Njesisë aktuale*



Formimi i Njesisë aktuale është njëra nga komponentët t projektit të Bankës botërore “Ndhimë teknike për përgatitjen e programit për kompensime sociale në Republikën e Maqedonisë”, i koordinuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Qëllimi i Njesisë aktuale është që ta përforcoj kapacitetin për zhvillim politik të pensioneve në Ministrinë e punës dhe politikës sociale dhe në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë. Njësia ka kapacitet të përgatisë projeksione afatgjata për gjendjet në sistemin pensional, duke e marrë parasysh demografin dhe ekonominë, në kuadër të supozimeve të politikës për pensione. Njësia bën analiza që ti kuantifikon ndryshimet në ligjet të cilët e rregullojnë sigurimin pensional dhe invalidor dhe sferat e tjera të rëndësishme për zhvillimin e sistemit pensional.

Njësia aktuale filloi me punë në shtator të vitit 1995 në Fondin e SPIM-së, si subjekt i veçantë në Sektorin për çështje ekonomike – financiare. Nga fillimi i punës së Njesisë paralelisht zhvillohej edhe trajnimi i anëtarëve të saj.


Njësia, në bashkëpunim me konsulent, në vitin 1996, e formoi versionin fillestar të modelit aktuar, të dizajnuar sipas pakos Exel, me periudha të projeksioneve deri në vitin 2040. Gjatë vitit 1997 dhe 1998, Njësia dhe konsulenti Willem Schuddeboom punuan në zgjerimin e e modulit aktuar të përhershëm për sektorin publik dhe modelin e dizajnuar për financim kapital shtylla e dytë në sistemin pensional që në fund të vitit 1998, Njësia së bashku me konsulentin John Wilkin të bën konvertimin e modelit në gjuhën e programit Visual Basic for Applications (VBA). Në vitin 2000, Njësia së bashku me konsulentin aktuar Patrick Wiese formoi modelin aktuar për parashikime PRISM me periudhë 100 vjeçare të projeksioneve. Modeli gjatë vitit 2004 ishte plotësuar dhe në të u inkorporua dhe një model afatshkurte. Modeli gjeneron vlerësime mjaft precize gjatë të hyrave dhe të dalurave të Fondit të SPIM-së, qartë i shpërndan obligimet për shpenzime nga FSPIMsi dhe ndikimi i pensionimit të parakohshëm. Modeli vazhdimisht azhurnohet me të dhëna të reja të marra nga Fondi i SPIM-së, Enti për statistikë dhe nga Ministria e financave.

Gjatë viteve të fundit Njësia trajnohej për shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe ndërrimin e modelit të Patrick Wiese, i cili përgatiti udhëzues teknik dhe punonte me anëtarët e njesisë me qëllim të stërvitjes më të mirë të tyre për stimulimin e ndryshimeve në politikën pensionale.

Me shfrytëzimin e modelit, Njësia aktuale bënte skenario të ndryshme sipas qëllimeve i vendosur nga Komiteti për reformë pensionale dhe sipas kërkesave të Fondit

të SPIM-së, Ministrisë për punë dhe politikë sociale, Banka Botërore dhe Fondi monetar ndërkombëtar. Aktiviteti i rëndësishëm i Njesisë është analiza e bartjes të siguarve në sistemin e ri, vlerësimet e shpenzimeve transitive dhe mundësitë për financim të tranzicionit. Këta projeksione bëhet në bazë të tre grupeve ekonomike supozimeve si dhe supozimeve të ndryshme për numrit e të siguarve të cilët e bartin në shtyllën e dytë.

E rëndësishme për publicitetin e reformës të sistemit pensional ishte përgatitja e Modelit për llogaritjen e pensioneve të ardhshme të personave individual në sistemin e reformuar pensional i cili përmbahet në ueb faqen e reformës. Modeli kishte një rëndësi të veçantë për rrjedhën e reformës dhe ishte i dizajnuar me qëllim që t'u ndihmojë të siguarve në vendimin e tyre për kyçe në shtyllën e dytë të sistemit (varësisht nga gjinia e tyre, moshja, vitet e stazhit, parashikimet ekonomike etj.).



Njësia aktuale gjatë vitit 2008 vazhdoi që të punojë me konsulentin aktuar Patrick Wiese në ndryshimet e modelit aktuar PRISM, me periudhën e parashikimeve prej 70 vjet. Në modelin e ri të ndryshuar janë përmbajtur ndryshimet e fundit në sistemin pensional, siç është koncepti i bruto pagës, reduktimi i shkallës së kontributit për sigurim pensional dhe invalidor, të lidhur me harmonizimin e pensioneve si

dhe ndarjen detale të kontributeve dhe të siguarve mes shtyllës së parë dhe shtyllës së dytë. Me modelin edhe më tutje mundet që të stimulohet diapazoni i gjerë në politikën e pensioneve, përkatësisht më shumë lloje të reformave, reforma parametrike të financimit rrjedhës të shtyllës pensionale, dhe ndryshime lidhur me shtyllën e dytë. Modeli gjeneron të dhëna për të hyrat dhe të dalat e Fondit, të dhëna për pensione dhe shfrytëzuesit e pensionit sipas llojit të pensionit, shpërndarja e të siguarve ndërmjet shtyllës së parë dhe dytë dhe të dhëna tjera të rëndësishme nga sfera e pensionimit.

Kah mesi i vitit 2009 ishte e realizuar vizita e fundit e konsulentit aktuar Patrik Vajs si vazhdim i trajnimit aktuar e cila filloi në vitin 2008. Ky trajnim ishte pjesë e projektit SPIL të Bankës Botërore “Mbështetje teknike për ndërtimin kapacitetit të anëtarëve të Njesisë Aktuale në FSPIM”. Gjatë rrjedhës së trajnimit ishin të përfshira tema nga sfera e aktuaristikës të ndara në disa module:

- Koncepte themelore aktuale dhe financiare, pjesa 1 dhe pjesa 2
- Financim i pensioneve
- Modelim i sistemit pensional, pjesa 1 dhe pjesa 2
- Bazat e Visual Basic

Trajnimi ishte mjaft i rëndësishëm për anëtarët e Njesisë për aktualë meqë ishin zgjeruar dituritë në sferën e aktuaristikës. Gjatë vizitës së konsulentit ishte e bërë edhe një analizë më e thellë e sistemit pensional në Republikën e Maqedonisë, ndërsa pas ndryshimeve të fundit në shkallën e kontributit dhe kalimi ndaj konceptit në pagë bruto. Projeksionet janë bërë me indikatorë të rinj makroekonomik të marra nga Ministria e financave.

Gjatë procesit të trajnimit dhe ndjekjen e trendeve botërore në pjesën e aktuarve nga anëtarët e Njesisë kah mesi i vitit e përfunduan kursin dyjavor për Matematikë aktuale dhe sigurimi dhe morën titullin *aktuar të autorizuar dhe licencë për punë si aktuar i autorizuar*.

Gjatë vitit 2012, njësia për aktualë i kryente obligimet e rregullta të parapara me programin për punë si dhe të gjitha aktivitetet e dala urgjente.

Në fillim të vitit, me shfrytëzimin e modelit aktuar dhe metodave tjera aktuale të planifikimit u përgatitën analizë dhe Informacion për vëzhgimet e gjendjes financiare në Fondin e sigurimit pensional dhe invalidor në periudhën prej vitit 2008 deri 2011 me propozim masa dhe projeksione për periudhën prej vitit 2012 deri 2015. Në Informacionin u shfaq vëzhgimi për gjendjen e ardhshme financiare të Fondit, ndërsa pranë kësaj duke i përdorur indikatorët makroekonomik nga Ministria e financave dhe të dhënat për të hyrat dhe dalart e realizuara për vitin 2011, ndërsa me qëllim të reduktimit të PAYG deficitit.

Në periudhën e njëjtë, Njësia përgatiti përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga Organizata ndërkombëtare për sigurim social (ISSA) ndërsa të cilat ishin pjesë e Anketave globale pyetësor për anëtarësim në vitin 2012.

Gjatë muajit shkurt, u bë analizë e moshës mesatare të pensionistëve për periudhën e kaluar dhe projeksione deri në vitin 2015. Gjithashtu, Seksioni për koordinim buxhetor koordinohet me Seksionin lidhur me llogaritjet për koeficientë të valorizuar në nivel të vitit 2011.

Kah fundi i muajit mars, anëtarët e njesisë aktuale morrën pjesë në Kurs me profesionalizëm për aktuarë i mbajtur nga ana e Chris Daykin, ndërsa i organizuar nga ana e Shoqatës aktuale maqedonase.

Gjatë muajit prill dhe maj, Njësia morri pjesë në punën e Seksionit për kontrollin e të dhënave nga kontributet për sigurim pensional dhe invalidor, nëpërmjet kërkesave me të dhëna të [kyqura për borxhlinjtë të tatimpaguesve aktiv dhe jo aktiv sipas filialave. Në periudhën e njëjtë Njësia përgatiti projeksione për numrin e shfrytëzuesve të ndjerë për fond solidar – ndihmë pas vdekjes. Qëllimi i projeksioneve ishte që të analizohet dhe të ndërmarrin masa për lartësinë e mbajtjeve për fond solidar, me të cilin do të tejkalohet problemi nga mungesa për mjete dhe pagesë me kohë të ndihmës së pas vdekjes. Gjatë përgatitjes të parashikimeve të marra janë parasysh dy faktorë të rëndësishëm: kohëzgjatja e shfrytëzimit të pensionit dhe numri i shfrytëzuesve të ndjerë të pensionit.

Kah mesi i vitit, ishin të përgatitura dhe të dorëzuara deri në Agjencinë për supervizion të sigurimit pensional me financim kapital, projeksione afatgjate për numrin e anëtarëve, kontribute të paguara dhe mjete të akumuluar në shtyllën e dytë.

Projeksionet përfshijnë tri skena, me të dhëna të ndryshme karoekonomike dhe demografike.

Në periudhën e njëjtë u mbajt takim me përfaqësuesit e Bankës botërore, ndërsa lidhur me projeksionet për Buxhetin për periudhën 2013 deri në vitin 2015. përfaqësuesi i takimit kërkoi që të bëhen projeksione për gjendjet në sistemin pensional me indikatorët makroekonomik oficalisht të shpallur nga Ministria e financave.

Përgatitja e projeksioneve për Buxhetin e Fondit në më shumë skenare të ndryshme të cilët përfshiejnë rritje plotësuese për të dalat e pensioneve prej 5% në fillim të vitit 2013, ishin pjesë e aktiviteteve për këtë periudhë.

Kah fundi i vitit, përsëri me kërtkesë të Bankës botërore u përgatitën tabeëa me të dhëna statistikore për përpunim të Studimit për reforma pensionale për Europë dhe Azinë Qendrore.

Në fillim të muajit tetor në organizim të Fondit u mbajt Takimi i tretë i drejtorëve të fondeve për sigurim pensional dhe invalidor nga shtet e krijuara në territorin e ish Jugosllavisë. Njësia për aktuarë për nevojat e takimit përgatiti analizë krahasuese për sistemin pensional në Republikën e Maqedonisë dhe Sistemet pensionale në ish Republikat Jugosllave. Krahasimet ishin bërë lidhur me shkallën e kontributit, krahasimin të siguruarit me pensionist, pjesëmarrje e pensionit mesatar në pagën mesatare, pjesëmarrje e të dalave për pensione në bruto prodhimin vendor dhe etj.

Njësia gjatë vitit 2012 merr pjesëmarrje aktive në obligimet dhe detyrat e punës të cilët dalin si pjesë e e grupit punues për kapitullin 3.02 Lëvizje e lirë e punëtorëve dhe grup punues ESSPROS.

Paralelisht me të gjitha aktivitetet e nënvizuara më parë, Njësia punonte në përgatitjen e “Raportit për sistem pensional në Republikën e Maqedonisë me projeksione aktuale për vitin 2012”.

Gjatë vitit 2012 Njësia për aktuarë si pjesë nga obligimet e tij të rregullta vazhdoi me ndjekjen e shpenzimeve transitive dhe numrin e të siguruarve – anëtarët në shtyllëne dytë, si pjesë kryesore në planifikimin e Buxhetit të Fondit. Projeksionet për shpenzime transitive afatshkurte dhe afatgjate si rezultate dalëse fitohen nga modeli aktuar.



*Projeksione më të rëndësishme afatgjate për të ardhmen e sistemit pensional*

<i>SHPENZIME TRANSITIVE</i>									
viti/skenario	Në raport me BPV			Në milion denarë vlerë e tanishme)			Në milion euro (vlera e tanishme)		
	optimiste	bazike	pesimiste	optimiste	bazike	pesimiste	optimiste	базични	песимистички
2014	0,99%	0,98%	0,98%	4.717	4.566	4.495	72,869	70,535	69,429
2015	1,07%	1,05%	1,04%	5.004	4.765	4.653	81,371	77,486	75,655
2016	1,14%	1,12%	1,12%	5.632	5.271	5.107	91,582	85,701	83,038
2017	1,22%	1,20%	1,18%	6.321	5.817	5.557	102,779	94,578	90,357
2018	1,30%	1,27%	1,25%	7.087	6.413	6.040	115,233	104,274	98,218
2019	1,37%	1,34%	1,31%	7.914	7.042	6.538	128,680	114,504	106,317
2020	1,44%	1,41%	1,38%	8.537	7.714	7.060	138,821	125,427	114,792
2025	1,73%	1,68%	1,59%	11.671	10.239	8.807	189,766	166,494	143,197
2030	1,81%	1,74%	1,58%	14.355	12.086	9.683	233,423	196,518	157,443
2035	1,46%	1,37%	1,18%	13.474	10.796	8.031	219,086	175,545	130,581
2040	0,91%	0,78%	0,57%	9.707	6.978	4.282	157,843	113,461	69,625
2045	0,05%	0,00%	0,00%	583	0	0	9,472	0,000	0,000
2050	0,00%	0,00%	0,00%	0	0	0	0,000	0,000	0,000

***SHPENZIME PËR PENSIONE***

viti/skenari	Në proporcion me BPV			Në milion denarë (vlera e tanishme)			Në milion euro (vlera e tanishme)		
	optimist	bazik	pesimist	optimist	bazik	pesimist	optimist	bazik	pesimist
2014	9,63%	9,75%	9,82%	45.662	45.273	45.169	742	736	734
2015	10,73%	10,94%	11,10%	52.920	52.252	52.047	860	850	846
2016	10,67%	11,02%	11,25%	55.308	54.425	54.108	899	885	880
2017	10,30%	10,78%	11,08%	56.205	55.134	54.712	914	896	890
2018	9,94%	10,53%	10,91%	57.190	55.930	55.404	930	909	901
2019	9,59%	10,28%	10,73%	58.225	56.778	56.157	947	923	913
2020	9,52%	10,02%	10,53%	59.295	57.658	56.928	964	938	926
2025	9,29%	9,88%	10,63%	66.174	63.504	62.042	1.076	1.033	1.009
2030	8,89%	9,62%	10,52%	74.337	70.512	67.928	1.209	1.147	1.105
2035	8,47%	9,27%	10,20%	82.060	76.968	72.822	1.334	1.252	1.184
2040	8,04%	8,90%	9,80%	90.485	83.740	77.398	1.471	1.362	1.259
2045	7,56%	8,45%	9,31%	98.043	89.282	80.488	1.594	1.452	1.309
2050	7,02%	7,91%	8,74%	103.401	92.400	81.351	1.681	1.502	1.323
2055	6,63%	7,49%	8,29%	109.948	95.918	82.320	1.788	1.560	1.339
2060	6,59%	7,41%	8,18%	124.007	104.767	87.144	2.016	1.704	1.417
2065	6,42%	7,20%	7,92%	139.507	114.272	92.161	2.268	1.858	1.499
2070	6,14%	6,89%	7,58%	157.360	125.208	97.931	2.559	2.036	1.592
2075	5,96%	6,70%	7,37%	181.132	140.057	106.212	2.945	2.277	1.727

<i>TË SIGURUARIT</i>						
	Shtylla e parë (gjithsej)			Shtylla e dytë		
viti/skenari	optimist	bazik	pesimist	optimist	bazik	pesimist
2014	553.497	544.634	538.356	370.794	364.857	360.651
2015	574.089	559.829	550.686	404.106	394.065	387.625
2016	598.308	577.063	565.683	440.845	425.175	416.780
2017	625.260	596.852	579.521	479.932	458.090	444.763
2018	653.596	617.490	593.897	521.756	492.868	473.992
2019	683.394	639.016	608.832	565.503	528.679	503.639
2020	693.102	661.475	624.351	593.182	565.970	534.109
2025	731.703	698.869	638.260	719.408	686.719	626.936
2030	764.975	725.728	645.185	833.413	790.071	702.109
2035	746.680	709.133	630.715	870.143	825.954	734.428
2040	730.486	693.772	616.720	879.584	835.246	742.435
2045	708.138	671.775	596.244	860.607	816.641	724.946
2050	676.993	640.773	567.344	811.714	768.652	680.767
2055	642.255	606.104	535.068	750.084	707.978	625.066
2060	613.156	576.669	507.383	711.261	668.936	588.565
2065	597.013	559.099	489.830	692.535	648.555	568.202
2070	592.312	551.737	480.727	687.082	640.015	557.644
2075	591.512	547.435	473.771	686.154	635.025	549.574

<i>PENSIONISTËT DHE KRAHASIMI NDËRMJET TË SIGURUARVE DHE PENSIONISTËVE</i>						
	pensionistë			Krahasimi ndërmjet të siguruarve dhe pensionistëve		
viti/skenari	optimist	bazik	pesimist	optimist	bazik	pesimist
2014	299.328	299.359	299.384	1,92	1,87	1,84
2015	304.366	304.517	304.643	1,97	1,90	1,86
2016	309.357	309.708	310.003	2,02	1,93	1,87
2017	314.413	315.039	315.564	2,08	1,96	1,88
2018	319.421	320.389	321.197	2,14	1,99	1,90
2019	324.137	325.504	326.644	2,14	2,03	1,91
2020	347.571	351.702	354.707	2,11	1,99	1,80
2025	369.485	377.427	382.205	2,07	1,92	1,69
2030	388.878	401.239	406.822	1,92	1,77	1,55
2035	410.695	427.568	432.390	1,78	1,62	1,43
2040	435.341	455.685	458.782	1,63	1,47	1,30
2045	461.277	483.222	484.119	1,47	1,33	1,17
2050	484.443	506.784	505.255	1,33	1,20	1,06
2055	496.792	519.290	516.075	1,23	1,11	0,98
2060	492.504	515.556	511.651	1,21	1,08	0,96
2065	476.613	500.480	496.360	1,24	1,10	0,97
2070	461.120	485.202	480.571	1,28	1,13	0,99
2075	295.146	295.144	295.141	1,88	1,85	1,82

<i>PENSIONET MESATARE (si % nga neto paga)</i>												
viti/ skenari	Pensioni i pleqërisë (PAYG)			Pensioni invalidor			Pensioni familjar			Gjithsej		
	I	II	III	I	II	III	I	II	III	I	II	III
2014	79,3%	80,1%	80,3%	63,1%	63,8%	64,0%	54,9%	55,5%	55,6%	70,5%	71,2%	71,4%
2015	80,1%	81,0%	81,4%	63,8%	64,6%	64,9%	55,5%	56,2%	56,5%	71,4%	72,3%	72,6%
2016	78,6%	79,7%	80,2%	62,7%	63,6%	64,0%	54,5%	55,3%	55,7%	70,2%	71,2%	71,7%
2017	77,1%	78,3%	79,0%	61,6%	62,6%	63,1%	53,5%	54,4%	54,9%	69,1%	70,2%	70,8%
2018	75,7%	77,0%	77,7%	60,5%	61,6%	62,2%	52,5%	53,5%	54,1%	67,9%	69,2%	69,8%
2019	74,3%	75,7%	76,5%	59,4%	60,6%	61,3%	51,5%	52,6%	53,2%	66,8%	68,1%	68,9%
2020	67,7%	69,4%	70,6%	54,4%	55,9%	57,0%	47,1%	48,4%	49,3%	61,5%	63,1%	64,3%
2025	60,3%	62,0%	63,4%	49,6%	51,2%	52,5%	43,3%	44,4%	45,5%	55,9%	57,6%	58,9%
2030	52,0%	53,6%	55,2%	45,5%	47,1%	48,5%	40,3%	41,3%	42,3%	50,6%	52,0%	53,3%
2035	50,4%	52,0%	53,6%	44,8%	46,3%	47,7%	39,8%	40,8%	41,7%	49,7%	51,0%	52,3%
2040	48,8%	50,4%	52,0%	44,1%	45,6%	47,0%	39,3%	40,2%	41,2%	48,8%	50,1%	51,3%
2050	47,2%	48,9%	50,5%	43,5%	45,0%	46,3%	38,8%	39,7%	40,7%	48,0%	49,2%	50,4%
2060	45,8%	47,4%	49,0%	42,9%	44,3%	45,7%	38,4%	39,3%	40,2%	47,3%	48,4%	49,6%
2070	44,3%	46,0%	47,6%	42,2%	43,7%	45,1%	37,9%	38,8%	39,7%	46,6%	47,7%	48,8%

I - skenari optimist

II – skenari bazik

III – skenari pesimist